



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15922 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

VENDIM

Nr. 108, Datë 23 . 09 .2022

**“PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË BANIMIT PËR SUBJEKTET PËRFITUESE
NË NDËRTESTAT (PALLATET) TË RINDËRTUARA PAS “TËRMETIT TË 26-
NËNTORIT” NË LAGJEN “GURRA”.**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 “Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimi Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.17, datë 03.02.2021 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet që do të akomodohen në Njësitë e reja të banimit në ndërtesat e reja të Rindërtuara në Lagjen “Gurra” të shpallur përfitues me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në

ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot 15922/
Dt 3.10.22.

K.B.

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 677/9 Prot.

Lezhë, më 03.10.2022

Lënda : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Për dijëni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma “b”, në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 13, pika 2, neni 29, pika 1, neni 54, gërma “k”, neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në ligjin nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 6.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga program i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr.108, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet përfituese në ndërtesat (pallatet) të rindërtuara pas tërmetit të 26 Nëntorit në lagjen “Gurra”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

